| 2.36 | Zgjidhja duhet te suportoje rutime dinamike: rutime te bazuara ne permbajtje gjate run-time, ne itinerar ose ne kontekst te shkembimit te te dhenave. Zgjidhja duhet te ofroje mundesine per te shkruar rregulla biznesi qe do te sherbejne si baze per rrugezimin. |
| 2.37 | Duhet te ofroje validim, agregim, filtrim dhe transformim te shkembimeve te te dhenave ne format XML. |
| 2.38 | Moduli i Integrimit te Aplikacioneve duhet te suportoje specifikimet WS-*. |
| 2.39 | Funksionalitet i detajuar per gjurmim auditimi. Duhet te ofrohet auditim per veprimet ne vijim: krijimi i objektit, modifikimi, fshirja, regjistrimi i emrit/ID-se se perdoruesit (ose aktorit te autentikuar) qe kryen veprimin dhe koha e sakte e kryerjes se veprimit. |
| 2.40 | Zgjidhja duhet te ofroje nje adapter off-the-shelf per integrim me SAP. Ky adapter nuk duhet te kete licence te veçante apo kufizime licencimi nga aspekti i integrimit, por duhet te perfshihet ne licencen e zgjidhjes kryesore.<br><br>Duhet te jete i disponueshem nje wizard per gjenerimin e objekteve te biznesit bazuar ne sherbimet e zbuluara ne serverin SAP, me qellim minimizimin e aktiviteteve te programimit. Artefaktet e gjeneruara duhet te jene te disponueshme ne flow per manipulimin e shkembimeve te te dhenave.<br><br>Adapteri duhet te suportoje Advanced Event Processing (AEP) dhe Application Link Enabling (ALE) per proçesimin hyres, si dhe Business Application Programming Interface (BAPI), AEP, ALE dhe Query Interface for SAP Systems (QISS) per procesimin dales. |

## 6.3 Shkembimi i te Dhenave

Zgjidhja duhet te suportoje mekanizma shkembimi te dhenash dhe menaxhimin e shkembimit te te dhenave ne nivel enterprise. Gjithashtu duhet te suportoj te dy modelet, si ate pike-me-pike (point-to-point), ashtu edhe ate asinkrone me komunikim jo te drejtperdrejt (publish-subscribe). Ajo duhet te garantoje shkembim te besueshem te te dhenave, pa dublime apo humbje, duke ruajtur integritetin transaksional dhe persistencen e mesazheve edhe ne rast deshtimi.

I gjithe komunikimi duhet te sigurohet me TLS, ndersa sistemi duhet te perfshije opsione per disponueshmeri te larte dhe rikuperim pas fatkeqesive. Shtresa e shkembimit te te dhenave duhet te ofroje nje konsole menaxhimi ne web, API REST per administrim, si dhe librari per gjuhe te ndryshme programimi, si C, Java, .NET dhe COBOL. Gjithashtu zgjidhja duket te suportoje edhe protokollet standarde MQ, AMQP, MQTT dhe HTTP.

| | |
|---|---|
| 3.1 | Aplikacioni duhet te ofroje kapacitete te shkembimit te te dhenave dhe radhitjes (queuing) ne nivel enterprise, permes menyrave te ndryshme te operimit: point-to-point dhe publish/subscribe. |
| 3.2 | Korniza e shkembimit te te dhenave duhet te suportoje API te ndryshme, perfshire Java™ Message Service (JMS), REST, .NET dhe MQTT. |
| 3.3 | Zgjidhja duhet te siguroje shperndarje nje here dhe vetem nje here, pa krijuar duplikime apo humbje te shkembimeve te te dhenave. |
| 3.4 | Duhet te jete i disponueshem nje pike e vetme per vizibilitet, menaxhim dhe kontroll te levizjes se shkembimit te te dhenave. |
| 3.5 | Zgjidhja duhet te trajtoje te gjitha shkembimet e te dhenave ne menyre transaksionale, per te siguruar sjellje te parashikueshme edhe ne situata deshtimi. |
| 3.6 | Zgjidhja duhet te mbroje te dhenat ne transmetim duke perdorur Transport Layer Security (TLS). |
| 3.7 | Zgjidhja duhet te kete kapacitete per high availability dhe rikuperim ne rast fatkeqesie (disaster recovery). |
| 3.8 | Aplikacioni duhet te ofroje nivele shume te larta te integritetit te te dhenave permes persistences se shkembimeve te te dhenave dhe kapaciteteve transaksionale, duke perfshire:<br>▪ Shkembime te dhenash persistente qe mund te mbijetojne edhe pas ri-startimit te çdo pjese te sistemit. Ato nuk duhet te humbasin, madje as gjate nderprerjeve te rrjetit apo deshtimeve te sistemit.<br>▪ Operacionet e mesazherise qe kryhen nga nje aplikacion duhet te mund te koordinohen me burime te tjera duke perdorur transaksione globale — si servere aplikacionesh dhe baza te te dhenave. |

| | |
|---|---|
| 3.9 | Zgjidhja duhet te ofroje nje konsole grafike te bazuar ne web per administrim dhe konfigurim. |
| 3.10 | REST API per administrim dhe REST API per shkembim te te dhenave duhet te jene te disponueshme.<br><br>REST API per shkembim te te dhenave duhet te mundesoje dergimin dhe pranimin e shkembimeve te te dhenave ne format tekst. |
| 3.11 | Korniza e shkembimit te te dhenave duhet te suportoje gjuhet e meposhtme proçedurale te programimit:<br>▪ C<br>▪ Visual Basic (Sisteme Windows vetem)<br>▪ COBOL<br>Gjithashtu, duhet te suportoje gjuhet e meposhtme te programimit te orientuara ne objekte:<br>▪ .NET<br>▪ ActiveX<br>▪ C++<br>▪ Java<br>▪ JMS |
| 3.12 | Korniza duhet te suportoje protokollet ne vijim: AMQP, MQTT, dhe HTTP. |

## 6.4 Menaxhimi i API-ve

Zgjidhja duhet te ofroje nje platforme te plote dhe bashkekohore per menaxhimin e ciklit jetesor te API-ve. Ajo duhet t'u mundesoje ekipeve te krijojne, ekspozojne, testojne dhe administrojne API-te REST, SOAP dhe GraphQL ne te gjitha mjediset. Karakteristikat thelbesore perfshijne transformimin e ngarkeses permes skriptimit ose XSLT, kontrollin e trafikut permes rate limiting, menaxhimin e versioneve, trajtimin e integruar te gabimeve dhe suport te plote per OpenAPI.

Platforma duhet te ofroje gjithashtu nje portal, te sigurt dhe fleksibel, i cili administron, analizon perdorimin si dhe mjete te integruara per publikimin e API-ve.

| | |
|---|---|
| 4.1 | Zgjidhja duhet te ofroje nje platforme te plote, moderne dhe intuitive per menaxhimin e ciklit te plote te API-ve, e cila mundeson krijimin, ekspozimin e sigurt dhe menaxhimin e API-ve ne mjedise te ndryshme cloud, per te fuqizuar aplikacionet digjitale. Platforma duhet te mbuloje te gjithe ciklin e jetes se nje API-ve — nga krijimi deri te fshirja. |
| 4.2 | Zgjidhja duhet te mbeshtese krijimin e definicioneve per REST API. |
| 4.3 | Zgjidhja duhet te mbeshtese krijimin e definicioneve per SOAP API duke u bazuar ne nje sherbim ekzistues WSDL. |

| | |
|---|---|
| 4.4 | Zgjidhja duhet te mbeshtese krijimin e nje definicioni REST API duke u bazuar ne nje sherbim ekzistues WSDL. |
| 4.5 | Zgjidhja duhet te mbeshtese krijimin e nje definicioni GraphQL API proxy. |
| 4.6 | Zgjidhja duhet te mbeshtese specifikimin OpenAPI 2.0 (Swagger). |
| 4.7 | Zgjidhja duhet te kete te integruar nje mjet per testimin e API-ve. |
| 4.8 | Zgjidhja duhet te ofroje editorin GraphiQL per te mundesuar testimin e API-ve GraphQL |
| 4.9 | Zgjidhja duhet te ofroje mundesine per te transformuar payload-in e definuar te API-te duke perdorur XSLT. |
| 4.10 | Zgjidhja duhet te suportoje nje gjuhe skriptimi per te transformuar payload-in e definuar te API-te |
| 4.11 | Zgjidhja duhet te ofroje funksionalitet per transformimin nga XML ne JSON dhe nga JSON ne XML. |
| 4.12 | Zgjidhja duhet te ofroje mundesine per te menaxhuar trafikun e API-ve permes percaktimit te kufizimeve te shpejtesise (rate limiting). |
| 4.13 | Zgjidhja duhet te ofroje autentikim Basic per te siguruar aksesin te API-te. |
| 4.14 | Zgjidhja duhet te ofroje siguri me API key. |
| 4.15 | Zgjidhja duhet te ofroje siguri me OAuth 2.0 per te siguruar aksesin te API-te. |
| 4.16 | Zgjidhja duhet te ofroje kapacitete te integruara per trajtimin e gabimeve. |
| 4.17 | Zgjidhja duhet te suportoje versionim te API-ve. |
| 4.18 | Zgjidhja duhet te suportoje menaxhimin e ciklit te jetes se produktit API, si p.sh. kalimi i nje produkti API nga nje gjendje ne nje tjeter. Per shembull, nga “published” ne “deprecated”. |
| 4.19 | Zgjidhja duhet te ofroje mundesine per te aprovuar ose refuzuar kerkesat per abonim (subscription) ne API. |
| 4.20 | Zgjidhja duhet te ofroje analiza te avancuara te perdorimit te API-ve. Duhet te ekzistoje kapaciteti per te zhvendosur lehtesisht te dhenat analitike drejt sistemeve te njohura si |

| | |
|---|---|
| | Splunk dhe te tjera, duke perdorur Syslog, Kafka, ose Elasticsearch. |
| 4.21 | Zgjidhja duhet te ofroje nje portal self-service te personalizueshem per publikimin e API-ve. |
| 4.22 | Portali self-service per publikimin e API-ve duhet te ofroje te pakten elementet e meposhtem te sigurise: CAPTCHA, reCAPTCHA, konfigurim te kohezgjatjes dhe kufizimit te sesionit, si dhe Honeypot per mbrojtje ndaj spam-it. |
| 4.23 | Portali self-service per publikimin e API-ve duhet te ofroje nje mekanizem te integruar per permbajtje sociale, si blogje, forume, lidhje me faqet e rrjeteve sociale dhe postime sondazhesh. |

## 6.5 Transmetimi i Eventeve ne Kohe Reale

Zgjidhja duhet te suportoje transmetim eventeve ne kohe reale permes nje sistemi asinkron me komunikim jo te drejtperdrejte (publish-subscribe) dhe te jete gjendje te operoje edhe nese paraqiten problematika apo gabime (fault-tolerant), te jete ne gjendje te procesoje ngarkese te larte ne kohe sa me te ulet. Ajo duhet te shkallezohet horizontalisht dhe te perfshije ndarje te brendshme (partitioning) dhe replikim te integruar per rikuperim pas fatkeqesive.

Nderfaqja administrative duhet t'u lejoje perdoruesve te shfletojne, filtrojne dhe inspektojne ne kohe reale volume te medha transaksionesh, me mundesi per t'u pergjigjur kerkesave per shkembim te dhenash dhe rishikim te ngjarjeve kronologjike. Platforma duhet te ofroje API REST per integrime te jashtme, te shtresezoje nivelet e aksesit sipas roleve dhe te funksionoje ne menyre integrale me shtresen e shkembimit te te dhenave per te suportuar event-driven applications.

| | |
|---|---|
| 5.1 | Zgjidhja duhet te ofroje kapacitete per event streaming ne kohe reale. Duhet te jete nje sistem messaging i bazuar ne modelin publish-subscribe, i ndertuar per te qene tolerant ndaj gabimeve, duke ofruar high-throughput dhe low-latency per trajtimin e flukseve te te dhenave ne kohe reale.<br><br>Qasja e bazuar ne evente siguron eksperienca te mira per perdoruesit. |
| 5.2 | Zgjidhja duhet te suportoje shkallezueshmeri horizontale. |
| 5.3 | Zgjidhja duhet te jete e lehte per t'u instaluar dhe per t'u perdorur. |
| 5.4 | Zgjidhja duhet te kete te integruara funksionalitetet per particionim dhe replikim. |

| | |
|---|---|
| 5.5 | Nderfaqja administrative (Administration UI) duhet te jete e disponueshme per te shfletuar shkembimet e te dhenave, duke mundesuar shikimin dhe filtrimin e qindra mijera shkembimeve, perfshire opsionin per te analizuar ne detaje permbajtjen e shkembimeve nga nje periudhe e caktuar kohe.<br><br>Ajo duhet te mundesoje inspektimin e topic-ve, duke nisur nga tendencat e pergjithshme te throughput-it ne kohe, deri te permbajtja individuale e shkembimit te te dhenave, edhe ne ngarkesa me throughput te larte. |
| 5.6 | Zgjidhja duhet te ofroje historik te pandryshueshem (immutable) te event stream-it si dhe kapacitet per replay te event stream-it. |
| 5.7 | Zgjidhja duhet te ofroje REST API per te ndihmuar ne lidhjen e platformes se event streaming me sistemet e jashtme. |
| 5.8 | Siguria e bazuar ne role duhet te jete e disponueshme ne nivel te detajuar per secilin topic. |
| 5.9 | Zgjidhja duhet te suportoje gjeo-replikim te integruar per rikuperim ne rast fatkeqesie (disaster recovery). |

## 6.6 Transferim i Shpejt i Skedareve

Zgjidhja duhet te mundesoje transferim te shpejte dhe te sigurte te skedareve per data set-e te medha, direktori deri ne nivel skedaresh individuale, permes rrjeteve WAN, duke shfrytezuar gjithe gjeresine e bandes. Zgjidhja duhet te ofroje mundesine qe ne menyre automatike te riprovoje dergimin ne raste te deshtimit ne tentativen e parve, prioritetizim te gjeresise se bandes, si dhe komponente per te integruar aplikacionet ne web. Transferimet duhet te realizohen manualisht, sipas orareve te caktuara ose ne menyre ciklike, gjithashtu platforma duhet te mbeshtese shfletues web, aplikacione desktop, aplikacione mobile, command-line, integrime te paleve te treta.

Kerkesat e sigurise perfshijne autentikim SSH dhe kriptim AES me çelesa 128, 192 ose 256-bit, si per te dhenat ne tranzit ashtu edhe per ato ne prehje (at rest) si dhe politika kriptimi te personalizuara per çdo perdorues.

Permeteper, zgjidhja duhet te suportoje grupim (clustering) me disponueshmeri te larte, komprimim (compression) te menjehershem, menaxhim te radhes se transferimit me opsionet pezullim, rifillim dhe anulim, si dhe kontrolle te detajuara te integritetit per çdo bllok te dhenash.

| | |
|---|---|
| 6.1 | Zgjidhja duhet te ofroje kapacitete per transferim me shpejtesi te larte te file-ve, direktorive dhe grupeve te medha te te dhenave, me shume perdorues, ne çdo distance permes rrjeteve me shtrirje te gjere (wide area networks). |
| 6.2 | Zgjidhja duhet te suportoje nje protokoll transferimi file-sh me performance te larte, qe siguron siguri ne nivel enterprise, dorezim te besueshem dhe perdorim te optimizuar te |

| | |
|---|---|
| | bandes. |
| 6.3 | Zgjidhja duhet te shfrytezoje plotesisht banden e disponueshme te rrjetit per nje transferim efikas, duke ofruar nje pervoje te mire me **retry** automatik dhe rifillim te transferimeve te pjesshme nga pika e nderprerjes. |
| 6.4 | Zgjidhja duhet te mundesoje transferime te shpejta dhe te besueshme. Duhet te lejoje transferimin manual ose automatik te file-ve dhe direktorive, si dhe planifikimin e transferimeve te perseritura. |
| 6.5 | Zgjidhja duhet te jete ne gjendje te alokoje banden e rrjetit bazuar ne prioritetin e transferimit. |
| 6.6 | Zgjidhja duhet te mundesoje lidhje me nje game te gjere opsionesh klientesh – duke perfshire aplikacione desktop dhe aplikacione mobile. |
| 6.7 | Zgjidhja duhet te ofroje funksionalitet automatik per retry dhe resume nga pika e nderprerjes. |
| 6.8 | Runtime-i i zgjidhjes duhet te jete i afte te integrohet brenda çdo aplikacioni web, per te sherbyer si struktura mbeshtetese me shpejtesi te larte per transferimin e te dhenave te bazuara ne file, permes internetit publik ose lidhjeve private IP. |
| 6.9 | Duhet te suportoje krijimin e transferimeve te planifikuara dhe te perseritshme (nje here ose periodike). |
| 6.10 | Duhet te suportoje autentikim permes Secure Shell (SSH), si edhe garantimi i integritetit te te dhenave per çdo bllok te transmetuar, per te mbrojtur asetet digjitale kritike. |
| 6.11 | Duhet te suportoje enkriptim te te dhenave me AES-128/192/256, si gjate transmetimit ashtu edhe ne pushim (in-transit dhe at-rest), si ne anen e klientit ashtu edhe ne anen e serverit. Duhet te jete e mundur konfigurimi i enkriptimit ne nivel perdoruesi, si edhe percaktimi i forces minimale te fjalekalimit. |
| 6.12 | Nisja e transferimeve duhet te jete e mundur nga shfletuesi web, aplikacioni mobil, klienti desktop, endpoint-i, command line ose nje klient i integruar nga pale te treta. |
| 6.13 | Duhet te suportoje opsionet per konfigurim te klastereve me high-availability (active/active ose active/passive), se bashku me shperndarje te besueshme qe perfshijne retry automatik dhe resume te transferimeve te pjesshme ose te deshtuara. |
| 6.14 | Zgjidhja duhet te ofroje kompresim inline, automatik, te shpejte dhe pa humbje, per te |

reduktuar madhesine e grupeve te te dhenave gjate transferimit.

6.15 Zgjidhja duhet te ofroje kapacitet per te anuluar, pezulluar, rifilluar ose riorganizuar transferimet ne pritje (queue).

## 6.7 Gateway Sigurie

Zgjidhja duhet te suportoje nje gateway sigurie modulare qe menaxhon ne menyre te sigurt integrimet permes protokolleve dhe kanaleve te ndryshme, duke perfshire API-te, Web, aplikacionet mobile dhe shkembimet B2B. Ajo duhet te mbeshtese SOAP, REST dhe sherbimet web, si dhe te siguroje mjete te brendshme per kriptim, autentikim, validim dhe kontroll trafiku. Nje nderfaqe grafike ne web duhet te mundesoje konfigurimet e rrjedhave te shkembimit te te dhenave pa kufizime shtese licencimi.

Gateway duhet te pranoje ndryshime politikash gjate ekzekutimit pa pasur nevoje per riboot te sistemit, te verifikoje identitetet permes LDAP, SAML ose certifikatave, dhe te integrohet me standardet e kontrollit te qasjes si OAuth dhe WS-*. Zgjidhja duhet te perfshije offload te SSL/TLS, auditim, diagnostikim, prioritetizim te bazuar ne SLA, si edhe funksione per optimizim dhe transformim protokollesh.

7.1 Zgjidhja duhet te ofroje nje gateway sigurie qe merr rolin e gateway-it te brendshem dhe te jashtem, per t'i mundesuar organizates permbushjen e nevojave te saj per siguri dhe integrim.
Ky duhet te jete nje gateway modular, i cili duhet te suportoje plotesish sigurimin e integrimeve qe perdorin formatet XML/JSON dhe protokollet SOAP, REST dhe Web Services.

7.2 Gateway-i i sigurise duhet te jete nje platforme unike dhe multikanale (multi-channel gateway), qe ofron sigurimin, integrimin, kontrollin dhe optimizimin e shperndarjes se ngarkesave te punes (workloads) nepermjet kanaleve te ndryshme, duke perfshire mobile, API, web, SOA, B2B dhe cloud.

7.3 Gateway-i i sigurise duhet te mundesoje nje mjedis grafik per perdoruesit dhe zhvilluesit, per konfigurimin e flow-it te perpunimit te informacionit/shkembimit te te dhenave brenda gateway-it, duke perfshire konfigurimin e veçorive te sigurise dhe te integrimit.

- Gateway-i i sigurise duhet te kete nje nderfaqe grafike (GUI) te bazuar ne web per perdoruesit, zhvilluesit dhe administratoret. Te gjitha funksionalitetet duhet te jene te perfshira brenda se njejtes GUI. Sistemi nuk duhet te kerkoje licenca per perdoruesit qe aksesojne keto nderfaqe.
- Gateway-i i sigurise duhet te suportoje stilin arkitekturor 'pipes and filters' brenda mjedisit grafik per perdoruesit dhe zhvilluesit.
- Mjedisi grafik per perdoruesit dhe zhvilluesit duhet te jete i integruar me sistemin dhe i bazuar ne web. Nuk duhet te kerkohet licence per perdoruesin apo zhvilluesin per te pasur akses dhe per te punuar normalisht ne te.
- Konfigurimi duhet te suportoje metoden 'drag and drop' per ndertimin e flow-ve te proçesimit te shkembimit te te dhenave, duke perdorur mjete dhe filtra te disponueshem out-of-the-box. Kjo metode duhet te suportoje konfigurimin e funksionaliteteve te nderlikuara dhe jo-standard te autentikimit apo elementeve te tjere te sigurise, si edhe

| | |
|---|---|
| | funksione te integrimit dhe transformimit te shkembimit te te dhenave.<br>▪ Gateway-i i sigurise duhet te kete filtra/mjete out-of-the-box per: enkriptim/dekriptim te shkembimit te te dhenave, validim te permbajtjes, mbrojtje ndaj sulmeve ne nivel permbajtjeje, nenshkrim digjital dhe validim te nenshkrimit, transformim te permbajtjes (any-to-any), autentikim dhe autorizim te derguesit, kontroll te flow-it dhe throttling.<br>▪ Te gjitha funksionalitetet e permendura duhet te jene te disponueshme per procesimin e shkembimit te te dhenave ne te dy drejtimet: si ne hyrje ashtu edhe ne dalje.<br>▪ Te gjithe filtrat e permendur duhet te jene te disponueshem out-of-the-box, me mundesi konfigurimi sipas skenareve specifike. Konfigurimi duhet te jete i thjeshte brenda mjedisit grafik te zhvillimit. |
| 7.4 | Krijimi i politikave te personalizuara, shtimi/heqja/ndryshimi i filtrave per proçesimin e shkembimit te te dhenave ose çdo operacion tjeter i lidhur me proçesimin e tyre, nuk duhet te kerkoje ri-startimin e sistemit. |
| 7.5 | Gateway-i i sigurise duhet te kete kontroll te rrepte te aksesit mbi te gjithe informacionin qe permban. |
| 7.6 | Gateway-i i sigurise duhet te parandaloje instalimin e interpretuesve te gjuheve programuese, per cilendo gjuhe programimi. |
| 7.7 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje operimin me me shume se nje nderfaqe rrjeti dhe me shume se nje domain, duke i sherbyer keshtu domain-eve te ndryshme njekohesisht. |
| 7.8 | Gateway-i i sigurise duhet te kete mbrojtje ndaj sulmeve XML DoS (XDoS) dhe rrjedhjeve te buffer-it. Duhet te parandaloje dokumentet XML dhe shkembimet e te dhenave te demshme, qofshin ato te krijuara qellimisht apo aksidentalisht, qe kalojne permes protokolleve te integrimit. |
| 7.9 | Gateway-i i sigurise duhet te perdoret si pike e centralizuar per kontrollin dhe zbatimin e politikave dhe funksioneve, duke perfshire: Autentikimin, Autorizimin, validimin e shkembimit te te dhenave, vendosjen e vulave kohore (timestamping), etj. |
| 7.10 | Gateway-i i sigurise duhet te ofroje zbatim te unifikuar te politikave dhe siguri te avancuar, duke mundesuar nje pike te vetme hyrjeje per te mbrojtur dhe aplikuar politika te njejta sigurie ne te gjitha kanalet e biznesit. |
| 7.11 | Gateway-i duhet te ofroje kapacitetet e meposhtme te sigurise:<br>▪ Autentikim dhe autorizim<br>▪ Perkthim i token-eve te sigurise<br>▪ Virtualizim i sherbimeve/API-ve<br>▪ Mbrojtje ndaj kercenimeve<br>▪ Validim i skemes se shkembimit te te dhenave<br>▪ Filtrim i shkembimit te te dhenave<br>▪ Nenshkrim digjital i shkembimit te te dhenave<br>▪ Enkriptim i shkembimit te te dhenave<br>▪ Integrim me skanim antivirus (AV scanning). |

| | |
|---|---|
| 7.12 | Gateway-i duhet te ofroje kapacitetet e meposhtme te kontrollit:<br>▪ Zbatim te kuotave dhe kufizimeve te shpejtesise (rate enforcement)<br>▪ Rrugezime (routing) te bazuara ne permbajtje<br>▪ Regjistrim te shkembimit te te dhenave (message accounting). |
| 7.13 | Gateway-i duhet te ofroje kapacitetet e meposhtme per optimizim:<br>▪ Suport per HTTP/2<br>▪ Offload per SSL / TLS<br>▪ Offload per JSON dhe XML<br>▪ Pershpejtim per JavaScript, JSONiq, XSLT dhe Xquery<br>▪ Caching i pergjigjeve (response caching). |
| 7.14 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje metodat e meposhtme te enkriptimit: XKMS, RSA, 3DES, DES, AES, SHA, X.509, PKCS, CRLs, OCSP, XML, SSL, si edhe per nenshkrimin digjital dhe vendosjen e vulave kohore (timestamp). |
| 7.15 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje enkriptim dhe nenshkrim si ne nivel fushe te vetme (field), ashtu edhe te te gjithe dokumentit. |
| 7.16 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje protokolle dhe metoda te ndryshme te kontrollit te aksesit, duke perfshire: OAuth 2.0, XACML, Security Assertion Markup Language (SAML), SSL, TLS, LDAP dhe RADIUS. |
| 7.17 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje per SSL v3.<br>Gjithashtu, duhet te suportoje TLS versionet 1.0, 1.1, 1.2 dhe 1.3. |
| 7.18 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje te gjitha standardet WS-*. |
| 7.19 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje WS-Policy Framework dhe WS-Policy Attachment. Sistemi duhet te suportoje futjen automatike te metadata-ve WS-Policy ne WSDL, ne menyre qe klientet te mund te gjenerojne automatikisht kerkesa ne perputhje me politikat e percaktuara. |
| 7.20 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje SAML versionet 1.0, 1.1 dhe 2.0. |
| 7.21 | Per verifikimin dhe validimin e identitetit te perdoruesit, gateway-i i sigurise duhet te suportoje:<br>▪ Validimin e certifikates<br>▪ Nxjerrjen e identitetit nga token te ndryshem sigurie qe mund te futen ne header te shkembimit te te dhenave<br>▪ Validimin permes nje provider te jashtem ose te brendshem te identitetit (p.sh. LDAP)<br>▪ Mekanizmi per ndertimin e proçesimit te personalizuar te flow-it te shkembimit te te dhenave, i pershkruar ne kerkesat e meparshme, duhet te mundesoje zbatimin e validimeve komplekse dhe jo-standarde te identitetit duke kombinuar metodat e kerkuara. |

| | |
|---|---|
| 7.22 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje validimin e shkembimit te te dhenave duke krahasuar te dhenat me skemen XML (XML Schema) te WSDL-se si dhe permes perdorimit te XSLT. |
| 7.23 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje SSL/TLS offload. |
| 7.24 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje funksionalitetin e auditimit te jashtem dhe te konfigurueshem. |
| 7.25 | Aksesi administrativ duhet te jete i siguruar permes SSL. |
| 7.26 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje SNMP per menaxhim ne distance. |
| 7.27 | Gateway-i i sigurise duhet te mundesoje nje game te gjere funksionalitetesh per diagnostikim dhe zgjidhje problemesh, duke perfshire testet kryesore ne nivel rrjeti (si ping, akses ne porta te largeta, etj.), si dhe gjurmimin dhe zgjidhjen e problemeve ne flow-t e shkembimit te te dhenave.<br><br>Gjithashtu, gateway-i i sigurise duhet te mundesoje kapjen e trafikut ne nivel rrjeti per analize dhe troubleshooting. |
| 7.28 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje prioritizimin e ekzekutimit ne perputhje me SLA-te e paracaktuara. |
| 7.29 | Gateway-i i sigurise duhet te mundesoje offloading te Web Services duke perdorur rutime me XPath, ne varesi te numrit te shkembimeve te te dhenave te realizuara. |
| 7.30 | Gateway-i i sigurise duhet te suportoje integrimin me çdo produkt UDDI. |
| 7.31 | Gateway-i i sigurise duhet te mundesoje kontrollin e nivelit te trafikut qe shkon drejt nje WebService specifik, si dhe kontrollin per lejimin ose ndalimin e shkembimeve te te dhenave qe vijne nga kliente apo segmente te caktuara te rrjetit.<br><br>Duke perdorur mekanizmin e kerkuar per kontrollin e flow-it te procesimit te shkembimeve, sistemi duhet te suportoje çdo operacion te personalizuar dhe kompleks ne kete drejtim. |

## 7. Mjediset e Instalimit

Platforma e integrimit duhet te instalohet ne dy mjedise te veçanta, ne Ambientin e Testimit dhe ne ate te Prodhimit (Production) bazuar ne topologji dhe fortifikime (hardening) te njejta. Mjedisi i Testimit sherben per zhvillim, konfigurim, testim te automatizuar dhe akseptance nga perdoruesit. Platforma

duhet te sherbeje si nje sandbox ku ndryshimet mund validohen ne menyre te sigurte nen kushte ngarkese ne shkalle prodhimi, pa ndikuar sherbimet operative.

Kalimi nga Testimi ne Prodhim duhet te realizohet vetem nepermjet artefakteve te nenshkruara dhe te versionuara, dhe duhet te perfshije kontrolle te automatizuara per regresion, performance dhe perputhshmeri me politikat e percaktuara.

Mjedisi i Prodhimit duhet te siguroje disponueshmeri te larte permes perdorimit te imazheve te pandryshueshme te ekzekutimit dhe duhet te pranoje vetem artefakte qe kane kaluar me sukses te gjitha fazat e Testimit.

Segmentimi i rrjetit dhe perdorimi i kredencialeve te veçanta per secilin mjedis jane te detyrueshme per te parandaluar levizjen horizontale midis tyre. Monitorimi dhe loget e centralizuara duhet te ofrohen permes paneleve te dedikuara per secilin mjedis.

Proçedurat e rikthimit duhet te jene te gatshme per te rikthyer shpejt cilindo mjedis ne nje gjendje funksionale te njohur me nderhyrje minimale manuale.

Kalimi i çdo funksionaliteti, moduli apo platforme nga ambienti i testimit (UAT) në ambientin e prodhimit (LIVE) duhet të kryhet vetëm nëpërmjet artefakteve të versionuara dhe të nënshkruara elektronikisht nga palët përgjegjëse.

Ky proces duhet të plotësojë detyrimisht kriteret e mëposhtme:

1. Versionim i qartë i aplikacionit dhe konfigurimeve
    - Çdo artefakt duhet të ketë identifikues unik versioni (v1.2.3, commit ID, datë etj.).
2. Nënshkrim dhe aprovim formal
    - Artefaktet duhet të jenë të nënshkruara nga zhvilluesi, përgjegjësi i testimit dhe drejtuesi i sektorit teknik përkatës.
3. Testime të automatizuara për:
    - Regresion – për të siguruar që funksionalitetet ekzistuese nuk janë dëmtuar.
    - Performancë – për të verifikuar ndikimin në shpejtësi dhe përdorim burimesh.
    - Përputhshmëri me politikat e sigurisë dhe arkitekturës – përmes kontrolleve automatike të politikave (p.sh. hardening, autentikim, logim, auditim).
4. Log i auditueshëm për kalimin në prodhim
    - Të ruhet një log i plotë i çdo release, përfshirë:
        - Data, ora, dhe personat përgjegjës
        - Lista e komponentëve të përfshirë
        - Rezultatet e testimeve automatike
5. Procesi i Deploy-imit duhet të kryhet përmes pipeline-ve CI/CD të miratuara, që përfshijnë:
    - Validime para-deploy

- Deployment të kontrolluar (blue/green, canary ose manual approval)
- Rollback automatik në rast dështimi

## 8. Disa integrime te realizueshme

Platforma e integrimit (Middleware/ESB/API Gateway) duhet të instalohet dhe konfigurohet në të gjitha sistemet që shkëmbejnë të dhëna ndërmjet tyre, me qëllim standardizimin e komunikimit, sigurinë e mesazheve dhe monitorimin e qarkullimit të informacionit.

Sistemet që përfshihen në skemën e integrimit janë si më poshtë:

1. Sistemi financiar (SAP)
2. Sistemi për Menaxhimin e Aseteve (Maximo )
3. Sistemi i Faturimit & Kujdesit ndaj Klientit (Billing & CRM)
4. Sistemi për Menaxhimin e Punës në Terren (WFM)
5. Portali Selfcare dhe Aplikacionet Mobile për Abonentët
6. Sistemi i Smart Meter (AMI / HES / MDM)
7. Platformat e Matjes Manuale
8. Sistemi i Menaxhimit të Energjisë & Balancimit (EMS/SCADA/OMS)
9. Sistemet GIS
10. Platforma e Analitikës (Power BI)
11. Sistemet te tjera te zhvilluar nga Departamenti I IT (dispecaeria, furnizuesi, fotokontrolli, nenstacionet, intranet, platforma e HEC-eve etj.)

Çdo instancë e platformës së integrimit duhet të plotësojë këto kritere:

- Instalim modular (on-prem) për ambient testimi dhe prodhimi
- Certifikata të sigurisë (SSL/TLS) për të gjitha endpoint-et e ekspozuara
- Logging & Audit trail për çdo thirrje API midis sistemeve
- Transformim dhe pastrim të të dhënave (Data Mapping/ETL) në rastet ku strukturat nuk përputhen
- Menaxhim versionesh API për të mbështetur ndryshime pa ndërprer

**Të gjitha detajet mbi integrimet do të përshkruhen në mënyrë të detajuar në dokumentin e Analizës së Biznesit*

# 9. Kerkesat e Infrastruktures

Platforma e integrimit duhet te funksionoje ne makina virtuale. Ajo duhet te jete e vendosur ne dy mjedise te ndara: Testim (Staging) dhe Prodhim (Production). Te dy mjediset duhet te ndjekin te njejten topologji dhe te zbatojne masa te njejta sigurie.




## Klasteri i Prodhimit (Production)

- Dy nyje te dedikuara per ngarkesat e punes (worker nodes), secila me se paku 2 core CPU dhe 64 GiB RAM.

## Klasteri i Testimit (Staging)

- Dy nyje te dedikuara per ngarkesat e punes (worker nodes), secila me se paku 1 core CPU dhe 16 GiB RAM, te projektuara per te mbuluar ngarkesat e testimit funksional, te performances dhe te akseptances nga perdoruesit.

| **Mjediset** | **Rolet e nyjeve** | **CPU per nyje** | **RAM per nyje** | **Nyje** | **CPU** | **RAM** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prodhim** | Ngarkesat e punes (Server integrimi) | 2 Core | 64 GiB | 2 | 4 Core | 128 GiB |
| **Testim** | Ngarkesat e | 1 Core | 16 GiB | 2 | 2 Core | 32 GiB |

punes

# 10.Fazat e Projektit

## - Faza e Planifikimit

Kjo faze vendos themelet organizative dhe operacionale te projektit. Gjate kesaj faze do te percaktohen objektivat e projektit, rezultatet e pritshme, metodologjia e garantimit te cilesise dhe strategjia e menaxhimit te riskut. Ne kete faze duhet te perpilohet nje plan veprimi i detajuar, i cili do te sherbeje si kornize udhezuese per zbatimin e te gjitha aktiviteteve te projektit.

## - Mbledhja e kerkesave dhe dokumentimi i analizes

Ne kete faze kerkohet zhvillimi i nje analize biznesit te detajuar per identifikimin dhe pershkrimin e çdo procesi i cili do te perfshihet ne platformen e integrimit. Kjo faze perfshin specifikim e hollesishem te kerkesave si ato funksionale po ashtu edhe atyre teknike. Plani i menaxhimit te projektit duhet te perfshije:

- *Rishikim i detajuar i projektit:* Analize e hollesishme e gjendjes aktuale te integrimive, duke perfshire menyrat e shkembimit te te dhenave, ndervaresite ndermjet sistemeve, kufizimet operacionale dhe perputhshmerine me objektivat e biznesit.
- *Identifikimi i nevojave te biznesit ndermjet departamenteve:* Kerkesat qe lidhen me sinkronizimin e te dhenave, automatizimin, raportimin dhe pajtueshmerine duhet te mblidhen nga te gjitha departamentet si: faturimi, sherbimi ndaj klientit, matja, financa dhe IT.
- *Dokumenti i Kerkesave Funksionale:* Pershkrim i detajuar i funksioneve te pritshme te shtreses se integrimit, duke perfshire nderveprimet ndermjet sistemeve, rastet e perdorimit te data-flows, logjiken e transformimit dhe orkestrimin e sherbimeve. Dokumenti duhet te shpjegoje se si proceset ndermjet sistemeve do te mundesohen, automatizohen ose permiresohen.
- *Strategjia e menaxhimit te cilesise:* Plani i testimit verteton se integrimet funksionojne ne menyre te besueshme ne regjim pune prodhimi. Ai duhet te perfshije testime funksionale, kontrolle te performances, verifikim te integritetit te te dhenave, testime te tolerances ndaj gabimeve dhe konfigurimin e monitorimit.
- *Plani i menaxhimit te riskut:* Identifikimi dhe vleresimi i risqeve qe lidhen me kompleksitetin e integrimit, kohen jashte funksionimit, humbjen e te dhenave, pajtueshmerine dhe kufizimet e burimeve. Çdo risk duhet te perfshije nje strategji per mitigimin e saj dhe analize te impaktit.

## - Faza e Projektimit

Kjo faze harton arkitekturen e shtreses se nderveprimit, e cila do te mundesoje komunikim te besueshem, te shkallezueshem dhe te sigurt ndermjet sistemeve ekzistuese. Ajo percakton rrjedhat e integrimit si per proçeset ne kohe reale, ashtu edhe per proçeset te skeduluara ne grupe, si dhe specifikon modelet e shkembimit te te dhenave si ato sinkron ashtu edhe per ato asinkron, sipas çdo kritikaliteti te secilit sistem. Faza e projektimit duhet te perfshije elementet e meposhtme:

- *Tipet e integrimit:* rruget e komunikimit ndermjet sistemeve per nderveprime ne kohe reale (sinkrone) dhe event-driven (asinkrone).
- *Modelet e shkembimit te te dhenave:* modele te pershtatshme, si kerkese/pergjigje ose publikim/abonim, te percaktuar bazuar ne kritikalitetin e sistemeve.
- *Definimet e API-ve:* kontratat e sherbimit, pike-fundet dhe skemat e te dhenave qe standardizojne qasjen dhe sigurojne sjellje te qendrueshme ndermjet nderfaqeve.
- *Rregullat e mapimit te te dhenave:* logjika e transformimit dhe maredhenia mes formateve te ndryshme te te dhenave ne modele te unifikuara ndermjet sistemeve.
- *Modelet e sigurise:* mekanizmat e autentikimit, autorizimit dhe enkriptimit qe mbrojne te dhenat gjate transmetimit dhe sigurojne zbatimin e kontrollit te aksesit.
- *Diagramet e sistemit dhe e nderfaqeve:* diagramet arkitekturore dhe dokumentacioni i nderfaqeve qe pasqyrojne implementimin, testimin dhe mirembajtjen ne te ardhmen.

### - Faza e Implementimit

Gjate kesaj faze ndertohet dhe konfigurohet shtresa e nderveprimit. Do te krijohen nderfaqet e integrimit, te zhvilluara ne perputhje me parimet e dizajnit modular dhe te riperdorshem. Aktivitetet kryesore jane:

- *Zhvillimi i nderfaqeve te integrimit:* ndertimi i konektoreve te sistemeve, konfigurimi dhe rutimit i shkembimit te te dhenave si dhe zbatimi i logjikes se transformimit.
- *Konfigurimi i API-ve dhe shkembimit te te dhenave:* vendosja e sherbimeve dhe endpointeve te API-ve te cilet suportojne komunikimin si sinkron, ashtu edhe asinkron.
- *Komponente modular dhe te riperdorshem:* krijimi i elementeve te perbashketa, si mapim dhe template sherbimesh.
- *Ngritja e sherbimit te monitorimit dhe logeve:* konfigurimi i paneleve operacionale dhe logeve te qenderzuara te cilat mundesojne: vrojtueshmeri, alerte dhe diagnoze te problematikave.
- *Siguria dhe zbatimi i politikave:* aplikimi dhe shtrengimi i politikave per: autentikim, limitim, kontroll i aksesit dhe verifikim te shkembimeve te te dhenave.
- *Instalim i ambientit te testimit:* fillimisht platforma do te instalohet ne mjedisin e testimit (Staging) per te verifikuar mirefunksionimin e saj dhe me pas do te instalohet ne ambientin e prodhimit (Production).
- *Dokumentimi i komponenteve te implementuar:* logjika dhe rrjedhat e integrimeve, konfigurimeve dhe parametrave te instalimit per te suportuar perditesimet dhe auditimet e ardhshme.

### - Faza e Testimit

Do te percaktohen skenare testimi te detajuar per te konfirmuar qendrueshmerine dhe besueshmerine e shtreses se integrimit. Keto teste do te sigurojne qe çdo shkembim i te dhenave te mbetet i detajuar dhe i besueshem. Plani i testimit duhet te mbuloje fushat e meposhtme:

- *Skenaret e testimit funksional:* hartimi i skenareve te testimit qe verifikojne saktesine e rrjedhave te te dhenave, orkestrimin e sherbimeve dhe logjiken e biznesit ne te gjitha sistemet e nderlidhura.
- *Testimi i performances dhe ngarkeses:* simulimi i shkembimit te te dhenave me volum te larte dhe transaksioneve te njekohshme per te matur reagimin dhe prurjen e sistemit.
- *Testimi i failover-it dhe qendrueshmerise:* verifikimi i sjelljes se sistemit gjate deshtimeve, duke perfshire logjiken e te provuarit perseri, mekanizmat e kalimit te sherbimit ne resurset aktive dhe konfigurimet e disponueshmerise se larte.
- *Testimet e sigurise:* vleresimi i kontrollit te aksesit, metodave te autentikimit, enkriptimit te te dhenave dhe ekspozimit ndaj cenueshmerive ne API dhe shkembimet e mesazheve.
- *Testimi i pergjithshem:* ekzekutimi i skenareve te proceseve te biznesit qe perfshijne disa sisteme, per te testuar ndervepruesshmerine dhe vazhdimesine e proceseve.
- *Shenimi i problematikave workflow i zgjidhjeve:* vendosja e proçedurave per te regjistruar, prioritizuar dhe zgjidhur çdo problem te zbuluar gjate testimit.

- **Faza e Trajnimit**

**Ne perfundim te testimit te suksesshem dhe korrigjimit te problematikave te mundshme qe do identifikohen gjate kesaj faze, Operatori ekonomik duhet te vijoje me pergatitjen dhe mbajtjen e seancave te trajnimit teknik per stafin IT te OSHEE. Ky trajnim duhet te jete jo me pak se 5 dite pune dhe duhet te fokusohet ne transferimin e njohurive dhe rritjen e kapaciteteve operuese de mirembajtese te stafit te OSHEE per platformen e integrimit.**

- **Raportim ne çdo faze**

Ne perfundim te seciles faze te projektit (Planifikim, Analize e Kerkesave, Projektim, Zbatim dhe Testim), OSHEE Group Sh.a. kerkon nje raport te detajuar te aktiviteteve te kryera. Çdo raport duhet te pershkruaje qarte detyrat e realizuara, statusin e perfundimit dhe elementet e dorezuar. Dokumentet duhet te pasqyrojne nje permbledhje te strukturuar te progresit te arritur gjate seciles faze dhe te sherbejne si evidence zyrtare e punes se kryer dhe rezultateve te arritura.

## 11. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 11.1 Vendndodhja

Takimet e punës, konfigurimet, zbatimet e ndryshimeve, trajnimet dhe ofrimi i shërbimit të mbështetjes do zhvillohen në zyrat e OSHEE sh.a..

OSHEE sh.a. do të ofrojë mbështetje logjistike, duke përfshirë sallat e takimit apo akseset qe mund te nevojiten ne infrastrukturat IT sipas rregullave te sigurise se institucionit.

## 11.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë per 8 (muaj) nisur nga kjo datë.

# 12 RAPORTIMI

### 12.1Kërkesat e Raportimit

Kontraktori me përfundimin e instalimeve. konfigurimeve, testimeve dhe trajnimeve per sherbimet e kryera, do të duhet të kryejë dokumentimin e gjithë procesit sic është paraqitur edhe në planin e punës. Kontraktori do të duhet të dorëzojë:

- Raport fillestar;
- Raportin e Instalimeve per sherbimet e kryera sipas fazave te pershkruara;
- Raportim periodik mujor gjate gjithe kohezgjatjes se kontrates per ecurine e realizimit te sherbimeve te kerkuara.

## 12.2 Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raportet apo dokumentacioni i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohen ndjekësit ose ndjekesve të projektit të identifikuar në kontratë. Ndjekësi ose ndjekesit e projektit jane përgjegjës për aprovimin e raporteve.

Raportet do të dorëzohen:

- Me email
- Me shkrese zyrtyare te firmosur nga ndjekësit e projektit për të dyja palët.

# 13 MIREMBAJTJA AKTUALE DHE MBESHTETJA TEKNIKE

Operatori ekonomik i kontraktuar do të ofrojë shërbime të plota mirëmbajtjeje dhe suporti për një periudhë 12 mujore nga momenti i përfundimit të implementimit, që përfshijnë:

- Mbështetje teknike 8x5 / 24x7 sipas nivelit të urgjencës
- Monitorim i performancës së integrimeve
- Zgjidhje për incidente kritike dhe jofunksionalitete
- Përditësime sigurie dhe patch-e
- Auditim periodik i trafikut dhe logëve
- Dokumentim i çdo ndërhyrjeje dhe propozime për përmirësim
- Ndihmë për zgjerimin e skenarëve të integrimit ose sisteme të reja

Tabela e përparësisë me përkufizimet përkatëse, përgjigjet dhe kohën e zgjidhjes:

| Përparësia | Përkufizimi | Koha e Reagimit | Koha Maksimale e Zgjidhjes | Shembuj Tipikë |
|---|---|---|---|---|
| **Kritike (P1)** | Ndërprerje totale e një sistemi kyç; nuk ka asnjë mundësi funksionimi alternativ; ndikon në shumë përdorues ose operacionet e biznesit janë të bllokuara. | Brenda 30 minutash | Brenda 4 orësh (24/7) | Sistemi Billing offline, API gateway offline, rrjet jashtë funksioni etj.. |
| **Lartë (P2)** | Funksionalitet i rëndësishëm është i kufizuar ose degradim serioz i performancës; ndikim i madh në procese, por ka alternativa të pjesshme. | Brenda 1 ore | Brenda 8 orësh | Ndërprerje në sistemin e leximit të matësave, probleme me integrimin SAP etj.. |
| **Mesatare (P3)** | Problematikë që nuk ndalon punën, por ndikon në efikasitetin e përdoruesit ose sjell vonesa. | Brenda 4 orësh | Brenda 2 ditësh pune | Gabim në një formular API, problem raportimi në Power BI |
| **Ulët (P4)** | Pyetje, kërkesë për përmirësim që nuk ndikojnë në funksionalitetin bazë. | Brenda 1 dite pune | Brenda 5 ditësh pune | Sugjerim për përmirësim. |

## 14 Parashikimi i buxhetit

| Nr. | Pershkrimi | Njesi | Sasi | Cmim njesi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Licensa per platformen e integrimit (perfshire mbeshtetje nga prodhuesi per 12 muaj) | cope | 1 | | |
| **2** | Sherbime te implementimit te platformes | cope | 1 | | |
| **3** | Trajnim te stafit IT | dite | 5 | | |
| **4** | Sherbime te suportit | muaj | 12 | | |
| | **Total** | | | | |

**Aneksi 3: Plani i Implementimit**

## 15 Afati i ekzekutimit te kontrates

| Faza | M1 | M2 | M3 | M4 | M5 | M6 | M7 | M8 | M9 | M20 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Faza e Planifikimit*** | X | | | | | | | | | |
| ***Mbledhja e kerkesave dhe dokumentimi i analizes*** | X | | | | | | | | | |
| ***Faza e Projektimit*** | | X | | | | | | | | |
| ***Faza e Implementimit dhe levrimit te licensave*** | | | X | X | X | X | | | | |
| ***Faza e Testimit*** | | | | | | | X | | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Faza e Trajnimit*** | | | | | | | | X | | |
| ***Dorezimi I sistemit*** | | | | | | | | X | | |
| ***Mirembajtje e Platformes*** | | | | | | | | | X | X |

**Shtojca 9**

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

1. **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës**, sipas Shtojcës 10.***

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit,* ***sipas Shtojcës 10.***

*b. Sigurimin e Ofertës,* ***sipas Shtojcës 3****;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike per realizimin e objektit te prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 198.550.000 (Njëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e peseqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH.**

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti / enti kontraktor.*

**2.2.2.** ***Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate 3 (tre) viteve te fundit 2022, 2023, 2024. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu te jene të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve te nenit 41, pika" c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.***

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates në nje vlere jo më të vogel se 79,000,000 (Shtatedhjete e nente milion) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- *Për përvoja te mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe te deklaruara ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara".*

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ISO 27001:2013 ose ekuivalente per sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit (e vlefshme) dhe **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente, per menaxhimin e sherbimeve te teknologjise se informacionit (e vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

